

# STATUTI

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

\* IB welding \* Sh.p.k

### HYRJE

Shoqëria Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "IB welding" Sh.p.k, themelohet në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit", sot me datë, 28.07.2021.

### Kreu I

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia dhe Adresa e Faqes së Internetit**

#### Neni 1

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit, Administratori**

- 1.1 Sot me datën, 28.07.2021, ditën e enjte, unë i quajhuri Islam BICI, i bir Haxhiu-t, lindur në datë 13.09 1978, në Manëz Durrës dhe banues në Manëz Durrës, mbajtës i dokumentit Kartë Idntiteti me Nr.Personal H80913004B, , shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, dhe
- 1.2 Igli BICI, i biri Rustemi-it lindur në datë 19.09 2002, në Manëz Durrës dhe banues Manëz Durrës, mbajtës i dokumentit Kartë Idntiteti me Nr.Personal K20918008J, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar Bazuar në ligjin Nr.9901 datë, 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" dhe në ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë, vendosëm të krijojmë me anë të këtij Akti Themelimi, me kapitalin tonë, me dy ortak, shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "IB welding " sh.p.k.
- 1.2. Emri i shoqërisë tregtare me pergjegjësi të kufizuar është "IB welding " Sh.p.k.
- 1.3. Administratori i shoqërisë tregtare "IB welding" Sh.p.k, për pesë vjet nga dita e regjistrimit është Z.Igli BICI

#### Neni 2

#### Objekti

Shoqëria "IB welding" sh.p.k, ka për objekt social ushtrimin e aktiviteteve të mëposhtme:

- Tregtimin prodhimin ,montimin ,saldimin , importin dhe eksportin me shumicë e me pakicë, të produkteveve qe rrjedhin nga punimet strukturore metalike ,tubacione ,sisteme elektrike dhe hidraulike si dhe aktiviteti i lidhur me mirmbajtjen ,riparimin dhe asistence teknike , ne emer te vet dhe per palet e treta . .
- Testimi dhe dizenjimi ,ndertimi,montimi, instalimi,mirmbajtja ,blerja ,dhenia me qera ,shitja ,menaxhimi i impjantave industriale ,infrastruktura civile dhe rjetet teknologjike perkatese ne sektore prodhues dhe shperndarjen e sistemeve te energjise elektrike ,bakrit dhe te fibrave optike ,shperndarjen e gazit ,avullit,dhe /ose ngrohjes , te ujit dhe pastrimit ,ndertimin e puneve te sherbimeve publike per transportin e lengjeve djegese ,impjantet e mbeturinave ne energji,trajtimi dhe rikuperimi i mbetjeve te ngurta urbane dhe mbeturinave industriale ,termocentraleve te eres ,impjanteve fotovoltaike ,impjantet hidroelektrike ,sistemet e parandalimit te zjarrit ,sistemet telefonike dhe sistemet e transmetimit ;mirmbajtjes ,riparimit menaxhimin e

grupeve gjeneruese ,turbinat me uje dhe gaz ,paisjet elektro mekanike per gjenerimin e energjise termike dhe elektrike .

- Te ndertimit ,restaurimin ,mirmbajtjen menaxhimin dhe monitorimin e puneve ndertimore te cfardo lloji ,duke perfshire ndertesat e parafabrikuara ,te pergjithshme dhe te specializuara ,ne cdo fushe ,punime civile ,togzime ,rruge ,det, hekurudhe ,ajror ,hidraulik,elektrik,kanalizim ,telekomunikim diga ,tunele ,punime strukturore metalike si dhe te gjitha aktivitetet qe lidhen me ekzekutimin e e punimeve .
- Te transportit rrugore , demolimi dhe mbetjet e ndertimit ,germimet dhe gure ,per palet e trete a si ne teritorin kombetare dhe nderkombetare ; kryerjen e operacioneve te ngarkimit dhe shkarkimit ,shperndarjes si dhe ekzekutimin e te gjitha veprimeve qe kane te bejne me operimin e transportit .
- -Te tregetimit me shumice dhe pakice ,dhenija me qera te automjeteve te transportit ,makina ,kamjone forklifts,vinca ,platforma ajrore ,shkalle levizese ,makineri bujqesore ,si pajisje te reja dhe te perdorura per ngritjen e dheut ,perfshire pjeset rezerve ne pergjithesi , dhe dhenien me qera te ketyre pasurive .
- -Veprimtarine e pasurive te paluajtshme ,perkatesisht blerjen ,posedimin ,mbajtjen ,shitjen ,shkembimin ,dhe transferimin per cfardo arsye ,ndertim ristrukturim menaxhim ,qira ,nen-qira dhe menaxhimi i pergjithshem i pasurive te patundshme te te gjitha llojeve .

### Neni 3

#### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë tregtare “IB welding” sh.p.k, do të jetë pa afat.

### Neni 4

#### Selia dhe Adresa Elektronike

- 4.1. Selia e shoqërisë tregtare “IB welding” Sh.p.k, është në Adresën;- Rruga Manëz – Durrës, Zona Kadastrale 2590 dhe me Nr.7/41 Pasurie Durrës., Durrës. Albania. Aktiviteti i saj mund të zhvillohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Ndryshimet do të pasqyrohen në regjistrin përkatës të QKB-së dhe do t’ju bëhen të njohur të tretëve.
- 4.2. Adresa e faqes së internetit të shoqërisë :- s’ka
- 4.3. Adresa e shoqërisë tregtare “IB welding” Sh.p.k, për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):

### Kreu II

#### KAPITALI

### Neni 5

#### Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali Themeltar fillestar i shoqërisë tregtare, “IB welding” sh.p.k, është 100, 000.00 lekë (njëqindëmijë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e mëposhtëm:

1. Ortaku themelues, Z.Islam BICI:
  - Zotëruesi 1 (një) kuote me vlerë të përgjithëshme 80,000.00 lekë (tetëdhjetëmijë), që përbën 80 % të Kapitalit Themeltar të shoqërisë tregtare “IB welding” sh.p.k;
2. Ortaku themelues, Z.Igli BICI:

- Zotëruesi 1 (një) kuote me vlerë të përgjithëshme 20,000.00 lekë (*njëzetëmijë*), që përbën 20 % të Kapitalit Themeltar të shoqërisë tregtare “IB welding” sh.p.k;

Kontributi mund të jetë në para ose në natyrë (*pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, apo të drejta*). Kapitali zotërohet nga dy persona fizik, dhe shoqëria tregtare do të vijoi të funksionojë si shoqëri me dy ortakë. Ky kapital vlen për regjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (Q.K.B).

- 5.2. Kontributet në para, do të paguhen plotësisht menjëherë. Kontributet në natyrë do t’i kalojnë shoqërisë menjëherë pas regjistrimit në QKB.
- 5.3. Pagesa e kontributit në para do të kryhet në llogarinë e shoqërisë, pranë Bankës “Inteza/Raiffeisen Bank Al.

## Neni 6

### Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 6.1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nëshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet me para, dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 6.2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin e tij themeltar të shoqërisë.
- 6.3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila merr vendim në të njëjtat kushte, që kërkohen për ndryshimin e Statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

- 7.1. Kuotat e Kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, e të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a. Kontributit në kapitalin e shoqërisë
  - b. Shitblerjen
  - c. Trashëgimisë
  - d. Dhurimit
  - e. Çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.
- 7.2. Pjesët e kapitalit themeltar, janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në Statut.
- 7.3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

## Neni 8

### Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të papaguara

- 8.1. Administratorët mund t’u kërkojnë ortakëve të shoqërisë, pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (*pas marrjes së njoftimit prej 14 ditësh të plota në të cilën përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës*), i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.
- 8.2. Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkarisht, dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

- 8.3. Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaje një interes mbi shumën e papaguar me një kamatvonesë prej 4% në vit, duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.
- 8.4. Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, administratorët mund të njoftojnë paraprakisht të paktën katërbëdhjetë Ditë të Plota personin përgjegjës, për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer sëbashku me shumën e mundëshme shtesë të kamatvonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklaratimin se në rast moszbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.
- 8.5. Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorëve, dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumën e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.
- 8.6. Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratorët konsiderojnë të përshtatshme.
- 8.7. Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuota, por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë, deri në datën e anulimit të kuotës, së bashku me kamatvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.

## **Neni 9**

### **Çertifikatat e Kuotave**

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një çertifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë me shumë se një çertifikatë për kuotat e zotëruara bashkarisht nga disa persona dhe dorëzimi i çertifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave, do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të rënditen në çertifikatën e kuotës. Çertifikata nuk do të gezojë cilësinë e letrës me vlerë.

## **Neni 10**

### **Kalimi me Kontratë i Kuotave**

- 10.1. Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratorët. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.
- 10.2. Administratorët mund të refuzojnë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKR, në rast se kjo kuota nuk është shlyer plotësisht ose në rast se Administratorët nuk janë dakord me personin të cilit i kalon kuota.
- 10.3. Nëse Administratorët refuzojnë të regjistrojnë kalimin e kuotës, ata do të njoftojnë për mospranimin personin të cilit i kalohen kuotat, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.

## **Neni 11**

### **Kalimi i Kuotave me Trashëgimi ose si Pasojë e Falimentimit**

- 11.1. Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët, në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i

vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij;

– “ *pavarësisht parashikimeve të këtij statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me personat e tjerë* ”.

- 11.2. Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratorët, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës, ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të një personi tjetër.
- 11.3. Personi, që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes, ose e falimentimit të një ortaku do të ketë të drejta që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKR.

## Neni 12

### Blerja e Kuotave të Veta

- 12.1. Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve, apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit, dhe Administratorët lëshojnë njëçertifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen.
- 12.2. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit.

## Kreu III

### Organet Vendimarrëse dhe Drejtuese

## Neni 13

### Organi Vendimarrës

- 13.1. Asambleja e Përgjithshme ortakëve është organi më i lartë, dhe i vetëm vendimarrës i shoqërisë, për çështjet themelore siç përcaktohet në nenin 81 të Ligjit. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në sesione të zakonshme, të paktën një herë në vit, e thirrur sipas rastit nga administratorët apo ortakët
- 13.2. Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të Statutit, sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 13.3. Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet emëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. ndryshimet e statutit;
  - c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
  - f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 13.4. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi, nga një ortak tjetër, apo një person i tretë.
- 13.5. Administratori i shoqërisë trgtare, nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve, në Asamblenë e Përgjithshme.
- 13.6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 14**

##### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes të Asamblesë së Përgjithshme**

- 14.1. Asambleja e Përgjithshme, thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë, ose nëse parashikohet nga Statuti, me një njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik, duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë, përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 14.3. Kur Asambleja e Përgjithshme, nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendim, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 15**

##### **Kuorumi**

- 15.1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 15.2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 15.3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri, jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 16**

##### **Marrja e vendimeve**

- 16.1. Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e Statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

- 16.2. Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - përcaktimin e shpërblimeve;
  - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 16.3. Në qoftë se shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme, ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra, nga ortaku i vetëm, regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore, dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - investime;
  - vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 16.4. Vendimet e paregjistruara, në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë, pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon, se i treti, ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta, nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.
- 16.5. Çdo ndryshim Statuti, duhet të depozitohet pranë QKR, për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

#### **Neni 17**

##### **Përfshirja nga e drejta e votës**

- 17.1. Ortaku, nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
- vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - dhënienose jo të përfitimeve të reja;
- 17.2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### **Neni 18**

##### **Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme**

- 18.1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë, nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë teleperformancën (konferencë call), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të ligjit. Ortakët që marrin pjesë me

- mjete komunikimi elektronik, kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numërit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- 18.2. Administratorët, caktojnë kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
  - 18.3. Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortaket e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
  - 18.4. Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme .
  - 18.5. Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund(*dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme*), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, shtyhet të pakten katërmbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të pakten shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date, dhe në të do të percaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.
  - 18.6. Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:
    - a. Kryetari; ose
    - b. Një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të pakten 5%(*pesë për qind*) të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortaku.
  - 18.7. Me përjashtim të kundërshtimit të një ortaku, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
  - 18.8. Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

## Neni 19

### Votat e Ortakëve

- 19.1. Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut(*në rastin kur është individ*), të pranishëm apo përfaqësuesit e tij të autorizuar ose ortakut(*në rastin kur është person juridik*), i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
- 19.2. Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet, që kanë të bëjnë me këtë kuotë.
- 19.3. Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

## Neni 20

### Votimi me Prokurë

- 20.1. Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku sipas formës së mëposhtme ose në formën që mund të miratohet nga Administratorët:

“.....SHPK.....”

Unë /Ne/të nënshkruarit/t,.....,në cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur,emëroj/me.....,ose në pamundësi të tij,.....,në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet me .....20.....,dhe në çdo mbledhje të shtyrë.Nënshkruar me.....20.....”

- 20.2. Në rastet kur dëshirohet t’u jepet ortakëve mundësia për të udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën veprimit, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratorët):

“.....SHPK.....”

Unë/Ne/të nënshkruarit/t,....., në cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/me.....,ose në pamundësi të tij,.....,në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë, dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet me .....20.....,dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Kjo formë do të përdoret për vendimet e përmendura më poshtë:

Vendimi nr.1 \* Pro \* Kundër.

Vendimi nr.1 \* Pro \* Kundër.

(\*Fshini zgjedhjen e padëshiruar)

Përveç, udhëzimeve të tjera,përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme. Nënshkruar me.....20.....”

- 20.3. Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitohet në selinë e shoqërisë, ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes, ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

- 20.4. Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit, jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*), sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 4, të këtij statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes, ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

## Neni 21

### Administrimi

- 21.1. Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose me shumë persona fizik si Administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5-vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte, pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).
- 21.2. Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të ligjit. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të

kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

- 21.3. Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme, është Z. Igli BICI.

Të dhënat e identifikimit:

- **Igli BICI, banues në Manëz, Durrës**

Specimenti i nënshkrimit:

- Igli Bici 

## Neni 22

### Kompetencat e Administratorëve

- 22.1. Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:
- të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
  - përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
  - pregatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsolidur dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme;
  - krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencës së shoqërisë;
  - kryejnë regjistrimin dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikon ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - raportojnë para Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme, me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut.
- 22.2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- Sipas bilancit vjetor, apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton se ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë, nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
  - Shoqëria propozon të shesë po disponojë në mënyrë tjetër, aktive, që kanë një vlerë më të lartë se 5% (përqind), të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
  - Shoqëria brenda 2 viteve të para, pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, pasuri që kanë një vlerë më të lartë se 5% (përqind), të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- 22.3. Nëse shoqëria emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 22.4. Asambleja e Përgjithshme, mund të shkarkojë administratorin, në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 23

### Përgjegjësitë e Administratorit

- 23.1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet;
- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në Statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 23.2. Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 23.3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 23.4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:
- u kthen ortakëve kontributet;
  - u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - jep kredi.
- 23.5. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht, ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës

### Neni 24

### Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorëve.

**24.1.** Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- a. personi nuk është Administrator, sipas parashikimeve të ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6, të nenit 95 të Ligjit;
- b. personi ndodhet në gjendje paaftësie pagueese;
- c. personi vuan, ose mund të vuaj nga çrregullime mendore;
- d. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë ;ose
- e. ka munguar për më shumë së gjashtë muaj radhazi pa lejen e administratorëve të tjerë në mbledhjet e administratorëve, të mbajtur gjatë kësaj periudhe, dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e Administratorëve, vendos ta shkarkojë nga detyra.

**Neni 25**

**Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorëve**

- 25.1. Administratorët shpërblehen në bazë të skemës së vendosur, nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me parashikimet e nenit 97 të Ligjit (LTSH)
- 25.2. Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurimeose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyre, apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara, ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese, ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (*përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en*), ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajnë kontribute në fonde të caktuara për dhënie e përfitimeve të tilla.
- 25.3. Administratorëve mund t'u paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzimet të tjera në lidhje me pjesmarrjen e tyre në mbledhjet e Administratorëve, ose të komiteteve të Administratoreve, ose të Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

**Neni 26**

**Mbledhjet e Administratorëve.**

- 26.1. Mbledhjet e administratorëve do të mbahen sipa nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.
- 26.2. Vendimet e mbledhjes së administratorëve merren me kuorumin e votave që mund të përcaktohet nga administratorët, dhe në rast se ky kuorum nuk është përcaktuar, ai do të jetë dy.
- 26.3. Asambleja e Përgjithshme cakton njërin prej administratorëve me detyrën e Kryetarit të mbledhjes së Administratorëve, i cili mund të shkarkohet në çdo kohe nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo mbledhje të Administratorëve në të cilat ai është i pranishëm. Në rast se kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen, apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga ora e caktuar për mbledhjen, Administratoret e pranishëm mund të emërojnë njërin prej tyre si kryetar të Mbledhjes.
- 26.4. Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.
- 26.5. Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e administratorëve, ose nga ndonjë komitet i Administratorëve, apo nga persona të cilët veprojnë në cilësinë si Administrator, pavarësisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e një Administratori, ose të njeri prej tyre ka qenë i skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëllë sikur këta

persona të ishin të emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si Administrator dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

- 26.6. Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë Administratorët, që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Administratorëve, ose nga komiteti i Administratorëve do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëlloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Administratorëve, e mbledhur dhe zhvilluar rregullisht.

#### **Neni 27**

##### **Kufizimet në Votimet e Administratorëve**

- 27.1. Administratorët nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Administratorëve, për çështje në të cilin këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit, deri në momentin kur në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të gjithë anëtarët kanë rënë dakort që:

*a. të autorizojë lidhjen e kesaj marrëveshje dhe*

*b. të autorizojë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.*

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm, ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit(QKR).

- 27.2. Vota e Administratorit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhjen në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë. Dispozitat e nenit 89 të Ligjit(LTSH), do të zbatohen lidhur me përjashtimin e Administratorit nga vendimet e marra në këtë mbledhje.
- 27.3. Në rast se në mbledhjen e Administratorëve ose të komitetit të Administratorëve diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një administratori, çështja mund të drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes dhe vendimi i tij lidhur me çdo Administrator të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë.

#### **Neni 28**

##### **Proçesverbalet e Mbledhjeve të Administratorëve**

- 28.1. Administratorët kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen proçesverbalet e:
- të gjitha takimeve të kryera nga Administratorët ;dhe
  - të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjeve të Administratorëve dhe komiteteve të Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këto mbledhje.

#### **Kreu IV**

##### **Viti financiar, Ekspertët**

#### **Neni 29**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 30**

##### **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar pregatit raportin me shkrim, për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **KREU V**

### **Dividendët dhe kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

#### **Neni 31**

##### **Dividendët**

- 31.1. Pas plotësimit të parashikimeve, të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 31.2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, ë gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumatat e paguara për kuotat për të cilat paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjestohen dhe paguhen në përpjestim të drejtë me shumatat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi, në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- 31.3. Asnjë dividend, ose pagesë në para që lidhet me një kuotë, nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
- 31.4. Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë me e detyruar që ta paguajë atë.

#### **Neni 32**

##### **Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund të vendosin të kalojnë në Kapitalin Themeltar të shoqërisë, fitimet e pashpërndara, të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencial, apo shuma të tjera për rezevat e kapitalit të shoqërisë.

## **Kreu VI**

### **Prishja. Riorganizimi i Shoqërisë**

#### **Neni 33**

##### **Prishja dhe likuidimi**

- 33.1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohe:
  - a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b. me vendim të Asamblese se Ortakeve;
  - c. me hapjen e procedurave të falimentimit;

- d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e. me vendim të gjykatës;
- 33.2.** Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1(një) apo disa likuidatore, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjëndjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre, dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij, emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët. Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.
- 33.3.** Në fund të procesit të likuidimit Likuiduesi, në përputhje me ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar të votave të Asambleja Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve, të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë, dhe për këtë qëllim mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve. Asambleja e Përgjithshme vendos, mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit, dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit.

#### **Neni 34**

#### **Bashkimi, Ndarja**

Shoqëria si subjekt tregtar me personalitet juridik, me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve, mund të vendosi bashkimin apo ndarjen e shoqërisë. Modalitetet për realizimin e këtij veprimi përcaktohen rast pas rasti me, dhe në përputhje me urdhërimet ligjore në fuqi.

#### **Neni 35**

#### **Shëndërrimi i Shoqërisë**

Shëndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionere, mund të kryhet vetëm me miratimin e shumicës së kualifikuar të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 36**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 37**


#### **Mosmarrëveshjet**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gatë ekzistencës së shoqërisë, ose gjatë periudhës së likuidimit, në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti ndërmjet ortakëve, ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve, midis shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen me ndërmjetësim, ose do të paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare. Gjykatë kompetente është ajo e vendndodhjes së Selisë së shoqërisë.

Ky STATUT është hartuar në tre (tre) kopje, në gjuhën shqipe me fuqi të njëjtë, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), dhe kopjet e tjera mbeten në dokumentacionin bazë të krijimit të shoqërisë “IB welding” Sh.p.k.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**\* IB welding \* sh.p.k**

**Z.Islam BICI**  
**Perf/ligjore Rustem Bici**

  
\_\_\_\_\_

**Z.Igli BICI**

  
\_\_\_\_\_